

**ARTI
FIGURATIV
PËR KLASËN
E**

8

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

Danço ORDEV
ARSIMI FIGURATIV PËR KLASËN VIII
TË ARSIMIT FILLOR NËNTËVJEÇAR

Recensentë:	Maja Raunik-Kirkov - kryetare Kasiopea Naumovska - anëtare Ilija Koçovski – anëtar
Lektor i botimit në maqedonisht:	M-r Elizabeta Rallpovska
Dizajni grafik:	Prof. Danço ORDEV Jovan ALEKSOVSKI
Përgatitja kompjuterike:	Jovan ALEKSOVSKI
Përkthyes:	Fikrije Qerimi
Redaktim profesional:	Prof. dr. Aslan Hamiti
Lektor i botimit në shqip	M-r Ismail Hamiti

Botues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shtyp: Evropa 92, Koçan

Tirazhi: 630

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr.10-1611/1 të datës 19.06.2009, lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:73/76(075.2)=18

ORDEV, Danço

Art figurativ për klasën VIII të arsimit fillor nëntëvjeçar /Danço Ordev.
- Shkup : Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2020. - 76 стр. : илустр. ; 30 см

ISBN 978-608-226-431-8

COBISS.MK-ID 111855882

Nxënës i dashur,


Edhe në këtë klasë do të takohesh me librin e artit figurativ. Në të janë dhënë shkurtimisht përmbajtjet të cilat i ke mësuar në klasat e kaluara që të përkujtohesh se çka keni mësuar në periudhën e kaluar. Por, janë dhënë edhe përmbajtje të reja për materialet dhe teknikat, shprehje tjera figurative dhe përmbajtje për krijimtarinë dhe emrat e artistëve figurativë të njohur vendas dhe botërorë.

Nga gjuha figurative do të takoheni me përmbajtje të reja për ndarjet e elementeve dhe principeve figurative.

Edhe këtë herë ju paraqesim shumë reproduksione nga artistë figurativë të mëdhenj si ilustrim i përmbajtjes së artit figurativ. Gjatë mësimit analizoji përmbajtjet e këtij libri dhe krahasoju me ilustrimet, e në veprat tua figurative paraqiti ndjenjat tua dhe mundohu që të bësh vepra figurative origjinale.

Shpresoj se edhe më tutje do të kënaqesh me lëndën e artit figurativ e cila do të paraqesë kënaqësi të veçantë.

Autori



AUTOPORTRETE TË ARTISTËVE TË NJOHUR FIGURATIVË

5



Lazar Liçenoski: **Autoportret**,
Vaj në pëlthurë



Keti Kolvic: **Autoportret**,
bronzë



Francisko Goja: **Autoportret**,
vizatim



Nikola Martinovski:
Autoportret, vaj në pëlthurë



Rembrant: **Autoportret**,
Vaj në pëlthurë



Van Gog:
Autoportret, vaj në pëlthurë

AUTOPORTRETI IM


(emri)

(mbiemri)

(klasa)

(shkolla fillore)

(vizato autoportretin personal
në hapësirën e zbrazët)



Pablo Pikaso:
Autoportret, vaj në pëlthurë

PËRMBAJTJA

6




ARTI	8
ARTI FIGURATIV	9
GJUHA FIGURATIVE	10
Vija.....	12
Ngjyra	13
Toni	14
Tekstura	15
Kahja	16
Madhësia	17
Forma-vëllimi	18
Hapësira	19
Kontrasti	20
Ritëm-përsëritje	21
Harmonia	22
Baraspesha	23
Gradacioni	24
Proporcioni	25
Bashkësia	26
Kompozicioni	27
Motivi	28



ARTI FIGURATIV	34
VIZATIMI.....	36
Vija.....	38
Toni	38
Hapësira	39
Lapsi	40
Flomaster.....	40
Tush.....	41
Bajc.....	41
Kompjuter	41

PËRMBAJTJA

7



PIKTURIMI	42
Ngjyra	43
Toni	45
Hapësira	46
Baraspesha	47
Akuarel	48
Temper.....	48
Gvash	49



GRAFIKA.....	50
Vija.....	52
Tekstura.....	52
Toni	53
Ngjyra	53
Forma	54
Monotipija	54
Gravura në bakër.....	55



SKULPTURA.....	56
Forma	58
Madhësia	58
Baraspesha	59
Ritmi	60
Vija.....	60
Ngjyra	61
Proporcioni	61
Hapësira	61



DIZAJN DHE KOMUNIKIME VIZUELE	62
GALERI E ARTISTËVE FIGURATIV MAQEDONAS	66
FJALOR I SHPREHJEVE.....	68
TEST 1	70
TEST 2	72



LETËRSI

Njeriu kreativitetin e vet e shpreh në më shumë sfera të artit. Të gjitha artet kanë mjete të veta me të cilat shprehen, muzika nëpërmjet tonit dhe melodisë, letërsia dhe teatri nëpërmjet fjalës, baleti nëpërmjet lojës e filmi nëpërmjet ngjarjes, fotografisë dhe fjalës.



MUZIKË



BALET




FOTOGRAFIA



TEATËR



FILM



FILM



VIZATIM

ARTI FIGURATIV

ARTI FIGURATIV

10

9

Nëpërmjet artit figurativ njeriu nga parahistoria e deri më sot ka shprehur vetveten, ndjenjat e veta, kohën në të cilën ka jetuar. Arti figurativ është gjurmë vizuale e kohës, e cila ka kaluar dhe dokument i historisë sonë.

Artistët figurativ veprat e veta i realizojnë në materiale të ndryshme. Sipas mënyrës së punimit të veprës, arti figurativ ndahet në vizatim, pikturim, skulpturë, grafikë dhe dizajn.



FRESKA



RELIEV



PIKTURË



PIKTURË



GRAFIKË



SKULPTURË



DIZAJN

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE


10

Të gjitha artet kanë mjetet e veta nëpërmjet të cilave paraqiten, muzika nëpërmjet tonit dhe melodisë, letërsia dhe teatri nëpërmjet fjalës, baleti nëpërmjet lojës, e filmi nëpërmjet ngjarjes.

Arti figurativ paraqitet nëpërmjet gjuhës figurative. Gjuha figurative është e përbërë prej elementeve dhe principeve figurative. Elemente figurative janë: vija, ngjyra, toni, tekstura, madhësia, kahja, forma, vëllimi dhe hapësira. Principe figurative janë: kontrasti, ritmi, harmonia, baraspesha, gradacioni, proporcioni, bashkësia dhe kompozimi.



VIJA




NGJYRA




KAHJA



TONI



TEKSTURA



MADHËSIA



FORMA




HAPËSIRA

GJUHA FIGURATIVE


ELEMENTE FIGURATIVE

02

11



KONTRAST



RITËM



BARASPESHË




GRADACION



HARMONI



BASHKËSI



PROPORCION




KOMPOZIM

Vija


Vija është një nga elementet e para figurative. Vijat ndahen në të drejta dhe të lakuara, por kemi edhe vija të trasha e të holla, të shkurta dhe të gjata. Kur vizatojmë mund të përdorim vija konturale dhe teksturale. Varësisht nga ajo se me çfarë materiale dhe në çfarë baze vizatojmë, dallojmë edhe vija sipas karakterit.



Vija të trasha dhe të holla



Vija sipas karakterit të materialit



Skica për objekt arkitektonik



Vija të drejta dhe të lakuara

Vinsent van Gog: **Anije**, tush, pendëVasko Tashkovski, **Të zgjuarit**, tush, pendëMjeshtër i panjohur: **Ruga e kryqit**, gravurë në dru

Vijë konturale dhe teksturale

Vijat zakonisht i fitojmë duke shënuar në bazë të caktuar, por mund të fitohen edhe në mënyra të ndryshme, edhe jo vetëm në letër por edhe në materiale dhe teknika tjera. Mund t'i fitojmë me shënim në vizatim, në pikturim, në gravurë në grafikë dhe skulpturë.

Jan Gujon: **Reliefë nga çezma e të virgjërve**, Paris

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

02

13

Ngjyra

Nga gjitha ndarjet e dimë se ngjyra ndahet në ngjyra primare dhe sekondare, kromatike dhe akromatike, të ftohta dhe të ngrohta, të ndritshme dhe të errëta, harmonike dhe kontrast.




Rreth i ngjyrosur



Ngjyra primare dhe sekondare




Ngjyra akromatike



Ngjyra të ftohta dhe të ngrohta (10 vite)

Artistët figurativë bëjnë kombinime të ndryshme të çuditshme me ngjyrat. Kur kemi vepër me sipërfaqe të ngjyrosura me ngjyra të forta dhe intensive, themi se kemi pikturë kolorite. Ndonjëherë pikturat mund të jenë të ngjyrosura me më pak ngjyra të cilat janë të ngjashme mes veti dhe e gjithë vepra duket më qetë në sytë e shikuesit.



Pol Sinjak: **Dru ngjyrë roze** në Sen Trope, vaj në pëlhurë



Vasilij Kandinski: **Disa rrethe**, vaj në pëlhurë (iluzion në hapësirë me madhësi)



Zlatko Prica: **Dredhues të çelikut**, vaj në pëlhurë (ngjyra të ftohta dhe të ngrohta)

Në pikturë artistët shpeshherë përdorin kombinime të ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta që të paraqesin dhe fitojnë iluzion në thellësi. Ngjyrat e ngrohta lënë mbresë të afërsisë, e ngjyrat e ftohta të largësisë, me të cilat mund të fitojmë iluzion në hapësirë.



Hapësirë me ngjyrë



Princ Ra-hotep dhe gruaja e tij Nofret, enë e ngjyrosur, Egjipt

Toni

Ton dhe valer kanë domethënie të njëjtë meqë valer është fjalë frënge për ton.


Toni është sasi e ndritshmërisë në një ngjyrë. Ngjyra në ton ndryshohet nëse shtojmë të bardhë dhe të zezë, ndryshohet vetëm toni në atë mënyrë bëhet më i ndritshëm dhe më i errët. Ekzistojnë tone kromatike dhe akromatike prej të cilëve bëhet shkalla tonale.



Tone kromatike



Tone akromatike

Konstantin Kaçev: **Letër e vonuar**, vaj në pëlhurëPablo Pikaso: **Tre gra në burim**, vaj në pëlhurë (ton)Piter Brojgel: **Peizazh nga Egjipti**, vaj në pëlhurë (iluzion në hapësirë)Zhorzh Sera: **Figurë**, Vizatim me thëngjill

Kur pikturojmë hapësirë, të hapur, të jashtme në natyrë apo të brendshme në ndonjë hapësirë, me përdorimin e toneve më të ndritshme dhe më të errëta mundemi të fitojmë iluzion të thellësisë, respektivisht larg dhe afër.

Rembrant: **Shën Lazar**, shkrim në bakër

Toni në natyrë (fotografi)

V. Beciq: **Natyrë e vdekur**, vaj në pëlhurë

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE


02

15

Tekstura

Tekstura është sipërfaqja e jashtme të cilën mund ta ndjejmë me prekje.

Dallojmë teksturë natyrale dhe teksturë artificial sipas prejardhjes së materialit.




Teksturë e fituar me vijë


Në të gjitha fushat figurative artistët e aplikojnë teksturën që t'i pasurojnë veprat e veta artistike. Tekstura dukshëm aplikohet në vizatim, pikturim dhe grafikë, por edhe skulptorët me thellësim dhe grafim e pasurojnë vëllimin e skulpturave të veta me vlera të reja.



Rembrant: **Shën Jeronimi nga trungu**, shënim në bakër



Teksturë me ngjyrë



Piter Brojgel: **Në gjueti**, shkrim në bakër



Van Gog: **Postieri Josep Roulin**, tush, pendë



Petar Mazev: **Figurë në hapësirë të kuqe**, vaj në pëlthurë



Vizatim i fëmijëve (teksturë)



Autor i panjohur nga Benin


Kahja

Kahja është element figurativ të cilin e definojmë si forcë vizuale e cila e lëviz syrin në kahje të caktuar.

Sipas lëvizjes së forcës vizuale dallojmë kahje horizontale, kahje vertikale dhe kahje të pjerrët në veprën figurative.



Mark Shagal: **Portret i dyfishtë me gotë verë**, vaj në pëlhurë (kahje e pjerrët)



Vajtimi i Krishtit, Freskë në Shën Pantelejmon, Shkup (kahje horizontale)




Reshat Ahmeti: **Ndodhi vertikale**, vaj në pëlhurë (kahje vertikale)



El Greko: **Portret i Shën Andrea**, (kahje e pjerrët)



Për dallim nga veprat tek të cilat është e shprehur kahje horizontale, kahje vertikale apo e pjerrët, tek disa vepra shikimi i syrit qëndron në brendësinë e veprës, që do të thotë se bëhet fjalë për vepër figurative pa kahje.



Edvard Munk: **Pubertet**, vaj në pëlhurë (kontrast i kahjeve)



Filip Profe: **Farë e keqe**, teknikë e kombinuar (pa kahje)

Rozeta nga katedralja (pa kahje)

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE


02

17

Madhësia

Madhësia është element figurativ i rëndësishëm i cili është i pranishëm në të gjitha fushat figurative, në vizatim, në pikturë, në grafitë, në skulpturë dhe në dizajn.


Varësisht nga ajo se çfarë madhësi do të përdorë autori në veprat e veta në atë mënyrë ato do të kenë ndikim të shikuesi. Nëse aplikohen madhësi të ngjashme, vepra do të jetë harmonike dhe do të ndikojë në mënyrë qetësuese.



Pit Mondrijan: **Kompozim në të kaltër**, vaj në pëlhurë (kontrast me madhësi)



Fernand Lezhe: **Grua në të kaltër**, vaj në pëlhurë (kontrast me madhësi të ngjashme)




Teo van Dizburg: **Kompozim**, (madhësi të ngjashme)

Nëse në veprën figurative kombinohen madhësi të cilat janë të ndryshme sipas madhësisë, respektivisht kontraste, ajo vepër do të duket dinamike dhe jo e qetë.



T, Kauzlariq: **Kudri D**, grafikë (madhësi të ngjashme)



Viktor Vazareli: **Zebegen**, gvash (madhësi të ngjashme)

Forma

Forma është pamja e jashtme e një forme të paraqitur në veprën figurative. Kemi forma dydimensionale dhe tredimensionale. Forma mund të jetë e hapur, e mbyllur dhe e perforuar. Forma tredimensionale ka edhe vëllim. Vëllimi është hapësira të cilën e zë forma tredimensionale e cila është mjet kryesor i të shprehurit në skulpturë e cila paraqet relief, plastikë të plotë apo mobil.



Formë e hapur, formë e mbyllur dhe formë e perforuar



Ivan Picelj: **Kompozim**, vaj në pëlhurë (formë dydimensionale)

Forma apo vëllimi mund të jenë të thjeshta apo të ndërlikuara. Forma e thjeshtë është e përbërë nga një formë (top, qershi, mollë, kokërr rrushi....).

Kur një formë është e përbërë nga më shumë forma të thjeshta të lidhura në mes vetes në një tërësi themi se ajo formë është e ndërlikuar (automobil, njeri, ndërtesë, biçikletë, dru etj...).




Kolak, Berjut, asht i elefantit, relief



Vëllimi ndjehet me shikim dhe me prekje, ai mund të jetë këndor, i thelluar, i zbrazët dhe i mbushur varësisht se si skulptori e formëson materialin.



Marisol: **Familje**, materiale të kombinuara



Skulpturë mobile

Henri Mur: **Familje**, vaj në pëlhurë (asht i ndërlikuar)

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

Hapësira

Hapësira është element figurativ.

Kemi hapësirë reale e cila na rrethon, dhe iluzion të hapësirës të cilën artistët e paraqesin në veprat e veta figurative. Artistët e paraqesin hapësirën në mënyra të ndryshme, me ngjyra të ndritshme dhe të errëta, me tone, me ngjyra të ngrohta dhe të ftohta, me forma të mëdha dhe të vogla, dhe me gërshetim të formave njëra pas tjetrës.



Incizim satelitor i Bolonjës



Manastiri Joakim Osogovski (hapësirë e jashtme reale)



Pol Kle: **Revolucion i viadukteve**, vaj në pëlhurë (hapësirë me gërshetim)


Iluzion i hapësirës mund të fitohet edhe me ndihmën e perspektivës ajrore. Hapësira në këtë mënyrë paraqitet me përdorimin e ngjyrave të ndritshme dhe të errëta. Në pjesën e përparme të peizazhit i cili pikturohet përdoren ngjyra të errëta dhe të forta, e për pjesët e largëta, male, fusha – përdoren ngjyra të ndritshme.




Rafaello: **Martesa e Marisë**, vaj në pëlhurë (perspektivë)

Paraqitja më reale dhe më bindëse e hapësirës në veprat figurative arrihet me përdorimin e perspektivës lineare.

Artistët me përdorimin e perspektivës kanë arritur rezultatet më të mira në paraqitjen e hapësirës së brendshme dhe të jashtme.



Perspektivë



Vizatim i fëmijëve (perspektivë)




Piter Brojgel: **Peizazh nga Egjipti**, vaj në pëlhurë (iluzion në hapësirë)


Kontrasti

Kontrasti sikur se të gjitha principet figurative mundet të aplikohen në të gjitha elementet figurative siç është: vija, ngjyra, toni, tekstura, kahja, madhësia, forma dhe hapësira. Të gjitha elementet mund të kombinohen në kontrast me vlerën e tyre.

Vija në vepër kombinohet me kontrastin e llojeve të vijave, të trasha-të holla, të shkurta-të gjata, të drejta-të lakuara.



Kontrast i vijave



Kontrast i vijave




Vepër e fëmijëve (kontrast i ngjyrave të ftohta dhe të ngrohta)


Madhësia e formave në një vepër mund të jetë shumë e madhe dhe shumë e vogël me të cilat krijohet kontrast.

Ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta, të ndritshme dhe të errëta janë kontraste sipas veçorive të veta dhe shpeshherë aplikohen që të potencohet kundërshtimi i tyre.

Toni, nga më i errëti e deri te më i ndritshmi mund të aplikohet në kombinim kontrast me të cilën ngjallet dinamika e veprës.

Mile Korubin: **Udhëtim i përbashkët**, vaj në pëlhurë (kontrast me ton dhe madhësi)Edo Murtiq: **Pikturë**, vaj në pëlhurë (kontrast me kahje)

Kontrast me ton

Huan Miro: **Personazhe dhe qen para diellit**, temperë në pëlhurë (kontrast me madhësi dhe ndritshëm-errët)Huan Miro: **Në rrotën e flaktë**, vaj në pëlhurë (kontrast me madhësi)

GJUHA FIGURATIVE

PRINCIPE FIGURATIVE


02

Ritmi

Ritmi si princip figurativ e rregullon përsëritjen e elementeve në pikturë, skulpturë, grafikë apo dizajn. Ritëm kemi kur një element me vlera të njëjta njëtrajtësisht përsëritet. Ky ritëm aplikohet që nga kohërat më të vjetra e deri më sot për dekorim në qeramikë, poçari, tekstil, arkitekturë etj.




Ritëm i rregullt



Ritëm i rregullt

Në veprat figurative shpeshherë aplikohet ritmi i lirë. Artisti në veprën e vet e paraqet ritmin lirshëm dhe ai është më shumë emocional dhe psikologjik sesa i njëtrajtshëm.



Etien Jules Mari: **Studim kromografik i motorikës së njeriut**, (ritëm i vijës)




Zhan Dibife: **Panoramë nga Parisi**, vaj në pëlhurë (ritëm i lirë)

Ritmi alternativ po ashtu shpeshherë aplikohet për dekorim të sendeve në jetën e përditshme të njeriut. Në këtë ritëm përsëriten dy apo më tepër vlera të ndryshme me të cilat pasurohet vepra figurative.



Ritëm alternativ



Ritëm alternativ



Vinsent van Gog: **Natë me yje**, vaj në pëlhurë (ritëm i lirë)

21


Harmonia

Harmonia është princip figurativ i cili i rregullon marrëdhëniet në veprën figurative. Me aplikimin e këtij principi në veprën figurative ndërtohen raporte harmonike në mes elementeve figurative.

Rregull themelore për fitimin e harmonisë në një veprë figurative është përdorimi i vlerave të ngjashme të vijës, ngjyrës, tonit, formës apo madhësisë. Ky princip quhet harmoni sipas analogjisë.



Harmoni sipas vijës



Harmoni sipas analogjisë me tekstura



Harmoni sipas analogjisë me ngjyrë

Harmoni sipas analogjisë është përdorimi i vijave të ngjashme të lakuara, të trasha apo të holla, ngjyra të ngjashme dhe të afërta të ngjashme e të afërta të errëta apo të ndritshme, madhësi të ngjashme të formave apo forma të ngjashme, këndore dhe të rumbullakëta.

Përveç sipas analogjisë kemi edhe harmoni sipas funksionit dhe harmoni sipas idesë. Që të dy llojet janë të lidhura me përmbajtjen e cila paraqitet me motivin, e jo me elementet figurative.




Jan Arp: **Lule**, vaj në pëlhurë (harmoni sipas analogjisë me formë)




Luka Dela: **Robëri**, detal nga reliefi (harmoni sipas analogjisë me formë)

Harmonia sipas funksionit fitohet kur në veprë do të paraqesim objekte të cilat janë të ndërlidhura mes veti, funksionalisht, si për shembull: brushë dhe paletë, gotë dhe shishe me pije, deti dhe barka, lapsi dhe letra, etj.

Harmoni sipas idesë fitohet kur në veprë do të paraqesim përmbajtje të motivit të cilat shënojnë ndonjë ide apo simbol. Për shembull: paraqitja e pëllumbit dhe degës (simbol i paqes) etj.



Harmoni sipas funksionit



Harmoni sipas funksionit



Harmoni sipas idesë

GJUHA FIGURATIVE

PRINCIPE FIGURATIVE


Baraspesha

Baraspesha është princip i cili i rregullon raportet dhe radhitjen e elementeve figurative në vepër si një tërësi. Ekzistojnë dy lloje të baraspeshës: simetrike dhe asimetrike.

Baraspesha simetrike në mënyrë të thjeshtë me anë të simetrisë i radhit vijën, ngjyrën, tonin, teksturën, madhësinë dhe formën. Tek baraspesha simetrike ato janë të radhitura në mënyrë identike, në anën e majtë dhe të djathtë të vepërës.




Simetri



Tempulli Taxh Mahall, Indi (simetri)




Simetri



Pablo Pikaso: **Natyrë e vdekur**, vaj në pëlhurë (baraspeshë asimetrike me formë dhe ton)



Vitrash **Makedonium**, Krushevë



Henri Matiz: **Kaubo**, vaj në pëlhurë (baraspeshë asimetrike)



Rozhe van der Vaden: **Zbritja nga kryqi**, vaj në pëlhurë (baraspeshë asimetrike)



Vladimir Georgievski: **Adam dhe Eva**, vaj në pëlhurë (baraspeshë asimetrike)

Baraspesha asimetrike fitohet me ndërtimin e baraspeshës, por jo me radhitje simetrike respektivisht identike. Me baraspeshë asimetrike mund të kombinojmë në një anë një sipërfaqe më të madhe, e në anën tjetër dy-tre më të vogla të cilat së bashku marrin sipërfaqe sikur se e madhja. Nëse bëjmë vepër me ton, në një anë gjysmë nëse kemi formë më të vogël me ton më të errët ajo do të jetë në baraspeshë me formën më të madhe me ton më të ndritshëm në pjesën tjetër.


Në mënyrë asimetrike ndërtojmë baraspeshë edhe me ngjyrë, edhe me teksturë, me vijë, me formë, në atë mënyrë që kërkojmë baraspeshë vizuale në anën e djathtë dhe të majtë të vepërës.

Gradacioni

Me gradacion shënohet mundësia e secilit element të kalojë nga një gjendje në tjetër, vija gradualisht të ndryshohet nga e drejtë në të lakuar, toni të kalojë nga i ndritshëm në të errët dhe anasjelltas, ngjyra të kalojë nga një në tjetër, forma prej katrorit në rreth, trekëndësh etj.




Gradacion me ngjyrë



Gradacion me teksturë



Gradacion me madhësi

Dushan Xhamonja: **Skulpturë**, metal
(gradacion me madhësi)Robert Delani: **Për nder të Bleriot**
akuarel në pëlhurë (gradacion me madhësi)

Gradacion me ton dhe formë

Me gradacion të tonit secilës formë dydimensionale mundet t'i japim iluzion vëllimi, respektivisht tredimensionalitet. Me përdorimin e tonit fitohet iluzion në thellësi, afër dhe larg kur duam të paraqitet hapësira në vepër.

Piter Brojgel: **Kulla e Babilonisë**,
Vaj në pëlhurë
(gradacion i hapësirës)

Gradacion me madhësi dhe ton



Gradacion me ton

GJUHA FIGURATIVE

PRINCIPE FIGURATIVE


02

25


Proporcioni

Proporcioni është pjesë e principeve figurative me të cilat rregullohen raportet e brendshme të përbashkëta të madhësive në një vepër figurative apo vepër arkitektonike.

Çdo herë artistët kanë anuar nga e bukura, nga idealja në paraqitjen e bukurisë së njeriut, të objekteve, të pikurës.



Partenon, akropol, Athinë




Katedrala Notër Dam në Paris



Leonardo da Vinçi: **Proporcioni i trupit të njeriut**

Gjatë historisë ka ardhur deri te gjetja e proporcioneve ideale të trupit të njeriut, në ndërtimin e tempujve dhe në proporcionin e radhitjes së elementeve figurative në një vepër figurative.


Proporcionin për raport më të mirë të madhësive e kanë quajtur prerja e artë. Prerja e artë aplikohet në artin figurativ, në grafikë dhe arkitekturë.



Njeriu ka arritur që të gjejë proporcione të cilat sipas shumicës së njerëzve janë më të bukurat. Ato raporte të proporcionit shumë piktorë, skulptorë dhe arkitektë i aplikojnë gjatë punimit të veprave të veta. Më së lehti do ta sqarojmë prerjen e artë me katror i cili është i shënuar me A, B, C, D. Atë katror e prejme për gjysmë me segment vertikal EF. Prej pikës E të segmentit me kompas në të majtë e transferojmë lartësinë EC të horizontales së poshtme me çka fitohet pika G. me këtë fitohet hapësirë e plotë në të cilën kemi prerje të artë.

Këtu shihet se ana e vogël BG ndaj të madhes AB ka raport të njëjtë sikur se AB ndaj AG.

Gjatë historisë është arritur deri te gjetja e proporcioneve ideale të trupit të njeriut, në ndërtimin e tempujve dhe proporcionit të radhitjes së elementeve figurative në vepër figurative.



Petar Halej, vaj në pëlhurë




Afrodita Knjijanska, Paraksitel, Greqi

Bashkësia

Bashkësia është një nga principet figurative të cilat e rregullojnë tërësinë në veprat figurative. Bashkësia në tërësi mund të arrihet në më shumë mënyra, me përdorimin e vlerave të njëjta apo të ngjashme dhe bashkësi me anë të dominimit.




Xhuzepe Kapagrosi: **Supervizioni 305**, (bashkësi me formë dhe madhësi dominante)



Bashkësi me teksturë

Bashkësi me përdorim të vlerave të ngjashme apo të njëjta kemi kur në vepër shprehemi me vija të ngjashme, tone të ngjashme, ngjyra të ngjashme, madhësi, forma apo kahje të ngjashme.



Jan Helion: **Kompozim**, vaj në pëlhurë (bashkësi me formë)



Bashkësi me dominim të formës



Teo van Duzburg: **Qendra simulative**, vaj në pëlhurë (bashkësi me formë dhe madhësi)

Bashkësi me anë të dominimit arrihet kur në vepër dukshëm dominon ndonjë nga elementet figurative, vija, ndonjë ngjyrë e caktuar, ndonjë madhësi e caktuar, kahje apo formë e caktuar.



Vepër e fëmijëve (bashkësi me ton)



Bashkësi me ngjyrë

GJUHA FIGURATIVE

PRINCIPE FIGURATIVE

02

27

Kompozimi

Kompozimi është princip figurativ i cili e rregullon radhitjen e përbashkët të elementeve figurative në gjithë veprën figurative. Nëpërmjet kompozimit vepra figurative duket harmonike, pa u shpërndarë apo të jetë e shpartalluar si tërësi.



Shtyp, Asiri, relief



Olga Rozanova: **Kompozim pa objekt**, vaj në pëlhurë (kompozim vertikal)



Pieter Brojgel: **I verbëri udhëheq të verbrin**, vaj në pëlhurë (kompozim i pjerrët)




Miodrag Popović-Miça: **Urbanizëm**, vaj në pëlhurë (kompozim horizontal)

Sipas radhitjes së vijave, ngjyrave, tonit, madhësisë, teksturës, kahjes dhe formave, dallojmë: kompozim horizontal, kompozim vertikal dhe kompozim diagonal. Definimi i llojit të kompozimit është i ndërlidhur me llojin e kahjes. Shpeshherë përputhen lloji i kahjes dhe kompozimit.



Hunder Vaser: teknikë e kombinuar (kompozim horizontal)




El Greko: **Ringjallje**, vaj në pëlhurë (kompozim vertikal)


Secila vepër nga arti figurativ është e krijuar me kombinim të përbashkët të elementeve figurative siç janë: vija, ngjyra, toni, kahja, tekstura, hapësira, madhësia, forma, vëllimi. Në të janë prezente edhe principet figurative të cilat i rregullojnë elementet figurative.

Duke e shikuar veprën figurative, në të mund të shohim ndonjë përmbajtje të njohur të paraqitur si portret, autoportret, karikaturë, figurë, akt, skena nga jeta e përditshme, kafshë, enterier, peizazh ose natyrë të vdekur.

Paraqitjen e gjërave në veprat figurative e quajmë motiv. Nëse në veprën figurative kemi vetëm kombinim të vijës, ngjyrës, tonit, teksturës etj., e nuk kemi motiv, themi se ajo vepër është abstrakte, respektivisht pa motiv.



Edo Murtiq: **Pikturë**, vaj në pëlhurë (pikturë pa motiv)



Francisko Goja: **Maja e veshur**, vaj në pëlhurë

PORTRETI

Nëse në veprën figurative është paraqitur fytyrë njeriu, themi se motiv i veprës është portreti. Secili artist kur paraqet portret të ndonjë personi mundohet që të paraqesë shprehjen dhe karakterin specifik të atij personi, e jo vetëm pamjen fizike.



Leonardo da Vinci: **Mona Liza**, vaj në pëlhurë



Blagoja Nikolovski: **Portret i një plake**, vaj në pëlhurë



Diego Velaskez: **Zonjë** nga Spanja, vaj në pëlhurë



Vasil Vasilev: **Ana**, dru



K. Mijiq: **Portreti i gruas sime**, vaj në pëlhurë

AUTOPOРТRET

Artistët figurativë shpeshherë paraqesin fytyrën e vet nëpërmjet vizatimit, pikturës, grafikës apo skulpturës. Vepra e tillë themi së është autoportret. Autoportreti mund të jetë vepër figurative e pavarur, e ndonjëherë artistët e kanë pikturuar autoportretin e vet në skena grupore në të cilat paraqitet ndonjë ndodhi historike apo biblike. Në atë mënyrë ne mësojmë se si është dukur ndonjë artist nga koha kur nuk ka pasur fotografi.



Nikola Martinovski:
Autoportret, vaj në pëlhurë

Albreht Direr: **Autoportret**,
vaj në pëlhurë



Pablo Pikaso: **Autoportret**



Keti Kolvic: **Autoportret**,
bronzë



KARIKATURA

Disa artistë në krijimtarinë e vet e paraqesin psikologjinë e njeriut, anën qesharake apo jonjerëzore të njeriut me çka potencojnë anën negative të njeriut. Në atë paraqitje karikohet pamja e personaliteteve dhe këtë motiv e quajmë karikaturë.



Onore Domie: **Konte**, bronzë



Onore Domie: **Këtë mundemi në mënyrë të qetë ta lirojmë**, litografi



Onore Domie: **Krispen dhe Skapen**,
vaj në pëlhurë

FIGURA

Veprat figurative shpeshherë na paraqesin figura të veshura të njerëzve nga periudha të ndryshme të historisë së njerëzimit.

Figura si motiv ka domethënie të madhe për ne për shkak se ajo është dokument nëpërmjet të cilit ne njohetomi me mënyrën në të cilën njerëzit kanë qenë të veshur në kohërat e kaluara.



Avgust nga Prima porte, Romë, mermer



Jan van Aik: **Xhovani Arnolfini dhe nusja e tij**, vaj në pëlhurë



Eduard Mone: **Frushash**, vaj në pëlhurë



Amadeo Modiljani: **Njeri me llullë**, vaj në pëlhurë

AKT

Që nga parahistoria e deri më sot artisti ka vizatuar, pikturuar apo nëpërmjet skulpturës ka paraqitur trupin e femrës apo të mashkullit pa veshje. Pothuajse nuk ka artist i cili në krijimtarinë e vet nuk e ka paraqitur bukurinë e trupit të njeriut.



Gaston Lashoz: **Grua e cila qëndron**, bronzë



Rubens: **Angelika dhe pustnik**, vaj në pëlhurë

ZHANËR

Shumë artistë në gjithë krijimtarinë paraqesin skena nga jeta e përditshme në kohën në të cilën kanë jetuar. Nëpërmjet veprave të tyre, ne sot njohemi me jetën e njerëzve në histori, si janë veshur, si dhe ku kanë jetuar, çfarë zakone kanë pasur, me cilat vegla janë shërbyer etj.

Ky motiv është dokument për kohën në të cilën është krijuar vepra.



Hubert Jan van Ajk: **Adam dhe Eva**, pikturë në dru



Sharden: **Kthimi nga tregu**, vaj në pëlhurë



Diego Velaskez: **Ujëmbartësi nga Sevilja**, vaj në pëlhurë



Luis le Nen: **Familje fshatare**, vaj në pëlhurë



Dega: **Grua e cila kreh flokët**, pastel



Piter Brojgel: **Dasmë fshati**, vaj në pëlhurë

KAFSHË

Disa artistë shpeshherë në krijimtarinë e vet kanë paraqitur kafshë të caktuara shtëpiake apo të egra. Paraqitja e kafshëve si motiv e quajmë animalizëm.


Për paraqitjen e kafshëve artistët kanë qenë të inspiruar nga bukuria e ndonjë kafshe të caktuar apo prej simbolit që paraqet ajo kafshë.



Hokusai: **Zogj**, drugdhendje me ngjyrë



Gilgamesh: **Zbukurim për kuti**



Ujkonja, Romë, bronz

ENTERIERI

Paraqitja e hapësirës së brendshme quhet enterier. Nëpërmjet vizatimit, pikturës apo grafikës, artisti paraqet hapësirën e brendshme të shtëpisë apo vendeve publike. Nëpërmjet këtij motivi njoftohemi me pamjen e vendbanimeve dhe vendeve tjera në të cilat kanë jetuar njerëzit.



Mjeshtri nga Flamale: **Blagovestie**, vaj në pëlthurë



Gustav Kurbe: **Atelie e piktorit**, vaj në pëlthurë



Vinsent van Gog: **Dhomë në Ari**, vaj në pëlthurë

PEIZAZH

Shumë vepra figurative na paraqesin bukurinë e natyrës e cila quhet peizazh. Nëpërmjet peizazhit na janë paraqitur bukuritë e maleve, liqeneve, pyjeve, lumenjve, fushave, qyteteve dhe rrugëve.



Piter Brojgel: **Peizazh dimri**, vaj në pëlhurë



Vinsent van Gog: **Fushë gruri**, vaj në pëlhurë



Rubens: **Peizazh me kështjellë**, pikturë në dru



Danço Ordev: **Fshat**, vaj në pëlhurë



Panoramë, fotografi



F. Kovaçević: **Peizazh dimri**, vaj në pëlhurë

NATYRË E VDEKUR

Kur artisti figurativ në veprën e vet ka paraqitur sende të ndryshme, bimë apo kafshë të vdekura themi se vepra është me motiv të natyrës së vdekur.

Nëpërmjet natyrës së vdekur artistët duan të na paraqesin bukurinë e vijës, pasurinë e ngjyrës dhe sipërfaqeve në veprat figurative.




Vilhem Klas Heda: **Natyre e vdekur**, pikturë në dru



Vinsent van Gog: **Lule**, vaj në pëlhurë

Vizatimi, pikturimi, skulptura, grafika, dizajni dhe komunikimet vizuale janë pesë fushat figurative nëpërmjet të cilave shprehet arti figurativ. Nëpërmjet të gjithë këtyre fushave figurative artisti figurativ kreativisht punon vepra figurative të cilat dallohen mes veti prej përdorimit të materialeve dhe teknikave, por edhe nga mënyra e shprehjes figurative.



VIZATIM



PIKTURË



SKULPTURË



DIZAJN

Vizatimi

Me vizatim fillon secila vepër figurative. Ideja për pikturë, grafikë, skulpturë, dizajn apo vizatim i pavarur, fillon me vizatim i cili më tutje zhvillohet në vepër përfundimtare. Vizatimi shprehet nëpërmjet shumëllojshmërisë së vijave, teksturës dhe me vlerat tonale. Jo rrallë vizatimi pasurohet edhe me forma të ngjyrosura apo me kolazhe.



VIZATIM



VIZATIM




VIZATIM

Pikturimi

Pikturimi është fusha më e theksuar figurative në art. Pikturimi paraqitet nëpërmjet ngjyrës, vijës, teksturës dhe sipërfaqeve të ngjyrosura. Në këtë fushë ekzistojnë materiale të ndryshme dhe teknika për pikturim, si dhe baza në të cilat vendoset ngjyra. Nga lloji i teknikës, varet edhe karakteri i veprës së gatshme figurative, respektivisht pikturës.



PIKTURË



PIKTURË



PIKTURË

FUSHA FIGURATIVE

Grafika

Fusha e vetme e artit figurativ në të cilën vepra figurative krijohet me anë të shtypit është grafika.

Në këtë teknikë artisti së pari veprën e punon në ndonjë bazë e cila i shërben si matricë për shtyp, respektivisht për shumëzim të grafikës në më shumë ekzemplarë.

Varësisht nga procesi i punës dhe llojit të bazës së përdorur për matricë, dallojmë më tepër lloje të teknikës së grafikës, siç janë: shtyp i lartë, i thellë, i rrafshët dhe i kombinuar.



GRAFIKË




GRAFIKË

Skulptura

Skulptura është fushë figurative specifike në të cilën përpunohen vepra figurative tredimensionale, respektivisht këto vepra kanë vëllim i cili merr pjesë të hapësirës.


Nëpërmjet hapave të ndryshëm siç janë: shtimi, nxjerrja, ndërtimi, modelimi, konstruktimi, aplikimi etj, artisti me materiale të ndryshme krijon vepër figurative në skulpturë.



SKULPTURË



RELIEF



MOBIL

Dizajn dhe komunikime vizuale

Dizajni është art figurativ i cili krijon pamjen e objekteve të cilat njeriu i shfrytëzon në jetën e përditshme. Artistët e kësaj fushe, të quajtur dizajnerë, përpunojnë pamjen e jashtme të automjeteve, lodrave, objekteve, mobileve, veshmbathjes, pllakateve, billboardëve, paketimet dhe pamjen e prodhimeve që shiten dhe shumë gjëra tjera të cilat janë të nevojshme në jetën e përditshme.



PLLAKATË



DIZAJN INDUSTRIAL



KOSTUME

Vizatimi është një prej fushave themelore figurative në art. Gjatë vizatimit, vepra figurative është vizatimi nëpërmjet të cilit shprehet artisti. Të gjithë artistët figurativë bëjnë vizatime apo skica të pavarura nëpërmjet të cilave shënojnë idetë e veta për pikturat, grafikën, skulpturat apo dizajnet e ardhshme.




Bizon, vizatim parahistorik



Lojë rituale: **Shpellë në Palermo**, vizatim në shkëmb

Skica është vizatim i shpejtë në të cilën me vija themelore shënohet ideja se si duhet të duket vepra figurative e ardhshme.

Për një ide mund të bëhen edhe më tepër skica nga të cilat do të zgjidhet më e mira. Sipas skicës, artisti punon vizatim në të cilin janë të definuar më shumë detaje që paraqet realizim të veprës figurative.




Skicë për vitrazh



Vizatim me laps

Vizatimi është veper artistike origjinale dhe e pavarur. Vizatimi punohet me materiale të cilat në baza të caktuara lënë gjurmë të llojit të vijave apo sipërfaqe. Më së shpeshti vizatohet me laps, thëngjill, shkumësa të ndryshëm, pastel, tush dhe bajc. Mund të vizatohet edhe me teknikat akuael, gvash dhe temperë, apo me këto teknika të ngjyroses vizatimi i përgatitur.



Ordan Petleski: **Vija të zeza III**, tush, pendë



Vizatim fëmijësh, 10 vjet, tush

Vizatimi i punuar me teknikë të caktuar mund të kombinohet me letër kolazhi të ngjyrosur me të cilën fitohet vizatim i kolazhuar.

Në skulpturë po ashtu vizatimi është i pranishëm si shprehje tredimensionale e quajtur vizatim-objekt. Ky vizatim punohet me materiale të cilat sugjerojnë vija në hapësirë.

Në veprat skulpturale shpeshherë artisti e gdhend vizatimin si vija dhe hapësira. Me vijën fitohet tekstura e cila kombinohet me vëllimin dhe formën.

Vizatimi sikur çdo vepër figurative mund të paraqet ndonjë përmbajtje të caktuar, respektivisht në vizatim mund të ketë motiv siç është: portreti, natyra e vdekur, peizazhi, figura, akti etj. Ky vizatim themi se është real. Nëse në vizatim nuk mund të shohim motiv themi se vizatimi është abstrakt.

Artistët shpeshherë gjatë vizatimit të portretit, figurës, aktit apo diçka të ngjashme shërbehen me vizim. Me ndihmën e vizimit shumë më lehtë mund të caktohen proporcionet e pjesëve të brendshme në një tërësi dhe me sukses më të madh të vizatohet portreti, akti apo figura.



Amadeo Modigliani: **Portret i Pol Aleksandar**, thëngjill në letër




Vëllai i të vdekurit, relief, Egjipt



R. Difi: **Muzikant**, tush, pendë



Pablo Pikaso: **Studio për perde**, laps.



Vizatim i fëmijëve tush



Vizatim i fëmijëve, tush, pendë

VIJA

Vija është mjete themelor i shprehjes në vizatim. Është e njohur se ekzistojnë dy lloje të vijave: të drejta dhe të lakuara, por vijat mund të jenë edhe: të trasha, të holla, të gjata, të shkurta, konturale dhe teksturale.

Bukuria e vizatimit është shfrytëzimi i kombinimeve të ndryshme të vijave. Vizatohet me vija të ngjajshme dhe kontraste, të shënuara në dendësi dhe kahje të ndryshme, më shpesh dhe më rrallë. Me vijat mund të fitohet edhe shrafi. Shrafi është kur vijat vendosen në kahje të njëjtë, njëra afër tjetrës apo kryqëzohen në kahje të kundërt.



Pablo Pikaso: **Piktor me model i cili thur**, gravurë bakri



Studim për duar, tush, pendë



Engr Luis Bertin, vizatim me laps




Emilio Greko: **Volto**, tush, pendë

TONI

Me vizatim mund të fitohen vlera tonale më të ndritshme dhe më të errëta. Me vija të vendosura më shpesh apo më rrallë në sipërfaqe mund të fitojmë iluzion të sipërfaqeve më të errëta dhe më të ndritshme. Me sipërfaqe më të ndritshme dhe më të errëta mund të fitojmë iluzion në hapësirë.



Zhorzh Sera: **Vizatues**, thëngjill



Zhorzh Sera: **Figurë**, vizatim me thëngjill

HAPËSIRA

Hapësirë reale është hapësira e cila na rrethon. Artistët në veprat e veta në mënyra të ndryshme kanë paraqitur iluzion të hapësirës. Iluzion të hapësirës nëpërmjet vizatimit mund të fitohet me gërshetim të formave. Nëse vendosim forma një pas një, fitohet ndjenjë për afër apo larg. Në këtë mënyrë bëhet edhe skena për shfaqje teatrale.

Nëse në vepër figurative vizatojmë forma më të mëdha apo më të vogla, fitojmë iluzion të hapësirës. Format më të vogla, si natyrë duken sikur të jenë më larg, e format më të mëdha duken sikur të jenë më afër.

Për shembull: nëse vizatojmë dy figura njeriu, një të vogël e tjetrën të madhe, ne kemi ndjenjë se e vogla është më larg dhe e madha më afër.

E njëjta ndodh me të gjitha format më të mëdha apo më të vogla. Në natyrë vendet më të afërta janë me ngjyrë më të errët, e ato më të largëta me ngjyrë më të ndritshme për shkak të largësisë dhe dendësisë së ajrit.

Paraqitja e hapësirës në këtë mënyrë quhet perspektivë ajrore. Në artin figurativ, iluzion i hapësirës me perspektivë ajrore fitohet me tone apo ngjyra më të ndritshme apo më të errëta.

Paraqitja më e saktë e hapësirës në një vepër figurative

fitohet me perspektivën lineare. Me perspektivën lineare nëpërmjet lidhjes së pikave të caktuara fitohet ndjenjë për njerëzit dhe objektet afër dhe larg.

Në këtë mënyrë e gjithë ajo që është më larg bëhet gjithnjë e më e vogël dhe humbet si pikë në fund të shikimit.



Perspektivë ajrore, fotografi



Iluzion i hapësirës me gërshetim




Sezan: **Mali shën Fitorja**, vaj në pëlhurë



Vasko Tashkovski: **Plazhi i dinozaurëve**, vaj në pëlhurë (hapësirë e madhe-vogël)



Pieter Brojgel: **Kulla e Babilonisë**, vaj në pëlhurë (gradacion i hapësirës)



Vinsent van Gog: **Anije**, tush, pendë

LAPSI


Të përkujtohem se lapsi është mjete themelor për vizatim. Me laps mund të fitohen vija të ndryshme, e njëkohësisht të fitohen edhe tone të ndritshme dhe të buta, të errëta dhe të forta. Me laps mund të hijezojmë sipërfaqe të caktuara, me çka fitojmë iluzion të vëllimit dhe thellësi.

Më së miri është të punojmë me laps të shënuar me B sepse ajo është shenja për butësinë e lapsit i cili në vete përmban më tepër grafit. Sa më i madh që është numri para shkronjës B, lapsi është aq më i butë, dhe shënon vija më të errëta, si për shembull: B2, B3, B4 etj.

Për vizatim me laps, bazë më përkatëse është letra gjysmë e vrazhdë në të cilën lapsi shpenzohet dhe lë gjurmë figurative.



Mikelanxhelo: **Studim për një nga Simbolet në tavan të Kapelës së Sistinës**, laps



Katerina Kavaseti: **Dru**, laps me ngjyrë



Vepër me laps



Engr: **Familja Stamati**, laps

FLOMASTER


Flomasteri shpesh përdoret për përdorim të përditshëm, e edhe për vizatim. Me flomaster vizatohet thjeshtë, nuk shpërndahet ngjyra, dhe lehtë dhe shpejt thahet, lë gjurmë të pastër dhe të qartë.

Për dallim nga teknikat tjera, tek flomasteri kemi numër të kufizuar të ngjyrave. Për punim gjashtë, dymbëdhjetë e rrallë herë më tepër.

Ngjyrat mund të përzihen mekanikisht që të fitohet ngjyrë e re, e në të njëjtën kohë edhe vijën të cilën e le flomasteri është e njëtrajtshme, e fortë dhe e ftohtë, pa mundësi për shumëllojshmëri.

Baza për punë me flomaster duhet të jetë e lëmuar, e më së miri është të përdorim hamer-letër.

Artistët pothuajse nuk vizatojnë me flomaster për shkak se kjo është teknikë e pacaktuar kohësisht, respektivisht nëse vizatimi me flomaster është eksponuar në hapësirë, pas një kohe të caktuar ngjyra e tij humb.



Vepër e fëmijëve, flomaster

TUSH

Tushi është mjet të cilin shpeshherë e përdorim për vizatim. Tushi është material i lëngshëm i cili për vizatim përdor pendë me maje të mprehtë, dru të mprehtë apo brushë të butë me maje. Gjatë punës me pendë të metaltë fitohen vija të pastra dhe të qarta, e kur përdoret brusha vizatohet me tush të holluar apo të pa holluar me ujë që të mund të fitohen më tepër vlera tonale.

Baza në të cilën vizatohet me tush duhet të jetë letër e lëmuar, e më miri është të jetë hamer. Hameri preferohet për shkak të vetisë së tij që vija të mbetet e pastër, e qartë dhe precize.

Ekziston vizatim i dredhur. Dredhimin e përdorim kur pikturojmë në një vizatim të punuar me vija që të mundemi t'i japim sipërfaqe të vizatuara. Dredhimi bëhet me tush të cilin e hollojmë me ujë dhe në tone të ndryshme e mbulojmë vizatimin e gatshëm, por mund të bëhet edhe në teknikat e pikturimit, gvash, akuaREL apo temperë me të cilat fitojmë të ashtuquajtur vizatim të ngjyrosur.



Vizatim me tush, pendë



Van Gog: **Urë me karrocë,** tush i dredhur



Henri Matiz: **Grua me bluzë e cila ëndërron,** tush, pendë



Rembrant: **Akt me djalosh,** tush, Brushë

BAJC

Mjet me të cilin mundemi të bëjmë vizatim, i cili sot më rrallë përdoret është bajci. Bajci sipas të gjitha dukurive është i ngjashëm me tushin, e karakteristika e tij është ngjyra specifike kafe-okër e cila vizatimit i jep bukuri figurative.



Vepër me bajc të dredhur

KOMPJUTER

Me ndihmën e kompjuterit, sot mund të krijojmë vizatime të ndryshme të cilat janë specifike për këtë teknikë.



Vizatim kompjuterik

Pikturimi është fushë e gjerë dhe e pasur figurative me shprehje dhe specifikacione të ndryshme figurative. Pikturimi paraqitet me ngjyrë dhe ton, me sipërfaqe të ngjyrosura, forma dhe vija, por edhe me aplikimin e të gjitha elementeve dhe principeve figurative, siç janë: tekstura, hapësira, madhësia, proporcioni, ritmi, harmonia, kontrasti, bashkësia, baraspesha, gradacioni, kompozimi dhe kahja.



Ikonë mesjetare:
Evangelisti Matej, ikonë

Piktura punohet me lloje të ndryshme të ngjyrave të cilat vendosen në bazë me ndihmën e veglave të ndryshme, më së shumti me brusha dhe shpaklla pikturimi.

Baza për pikturë mund të jetë: letër, pëlhurë, karton, qelq, metal, hapësirë muri apo dru. Varësisht nga ajo se në çfarë baze pikturohet, zgjidhet lloji i ngjyrës dhe i mjeteve për pikturim. Sipas teknikës së përdorur për pikturim, veprat figurative i quajmë si: tapiceri, mozaik, vitrazh, freska dhe teknika tjera të pikturimit.



Aksesorë për vizatim



Katedrale gotike në Çartres,
vitrazh

Si mjet më i ri me të cilin mundemi të bëjmë vepër piktorale është edhe kompjuteri. Me ndihmën e programeve dhe veglave të caktuara kompjuterike mundemi të krijojmë forma të ndryshme, sipërfaqe, në të cilat mundemi të vendosim vija, ngjyrë, tone dhe teksturë.



Dimçe Koco:
Njeri fisnik,
Vegla për pikturim tapiseri




Petar Mazev: Pjesë e mozaikut në
përmendoren e çlirimit në Veles,



Ikonë Jezus i plotfuqishëm, ikonë, Ohër



Detal nga veshje popullore maqedonase




Edgar Dega: **Estela Muson**, vaj në pëlthurë



Albert Gleizes: **Simfoni në vjollcë**, vaj në pëlthurë



Rubens Korubin: **Natyre e vdekur solemne**, akrilik në pëlthurë



Bazilika episkopie, Stobi, mozaik


NGJYRA

Krahas elementeve tjera figurative, ngjyra është shprehje themelore në pikturim. Të përkujtohem se ekzistojnë ngjyra primare dhe sekondare, kromatike dhe akromatike, se dallojmë ngjyra të ngrohta dhe të ftohta, të errëta dhe të ndritshme.

Ngjyra primare janë: e verdha, e kaltra dhe e kuqja, ndërsa sekondare janë, vjollcë, e gjelbër dhe portokallie.



Rreth i ngjyrosur



Ngjyra primare dhe sekondare




F. Kovaçević: **Peizazh dimri**, vaj në pëlthurë (harmoni me ngjyra akromatike)

Ngjyrat primare dhe sekondare quhen kromatike, e zeza, e bardha dhe tonet e tyre të përhitura akromatike.

Ngjyrat të cilat ndaj njeriut veprojnë ngrohtë janë: e verdha, verdhë-portokall, portokallia dhe e kuqja, ndërsa ngjyra të ftohta janë: e gjelbra, gjelbër-kaltra, e kaltra, kaltër-vjollcë dhe vjollcë.

Na kujtohet se tek ngjyrat më i njohur është kontrasti komplementar i cili e zmadhon intensitetin e dy ngjyrave komplementare. Çifte komplementare janë: e gjelbra dhe e kuqja, vjollca dhe e verdha, dhe portokallte dhe e kaltra.



Çifte të kontrastit komplementar




Vinsent van Gog: **Rrugë fshati në Avers**, vaj në pëlhurë (kontrast komplementar)



Kontrast komplementar



Endri Varhold: **Xhems Din**



Henri Matiz: **Madam Matis**, Vaj në pëlhurë (ngjyra të ngrohta dhe të ftohta)

TONI

E dimë se toni është element figurativ i cili cakton sasinë e dritës në një ngjyrë, respektivisht një ngjyrë të njëjtë mundet të ketë më tepër tone.

Toni fitohet kur një ngjyre i shtohet ndritshmëri apo errësirë, respektivisht ndriçohet me të bardhë dhe errësohet me ngjyrë të zezë. Për shembull, nëse të kuqes i shtojmë të bardhë mund të fitojmë të kuqe më të ndritshme, e po që se të kuqes i shtojmë ngjyrë të zezë do të fitojmë ngjyrë të kuqe më të errët.

Tone kromatike janë të gjitha tonet që fitohen kur ngjyra kromatike ndriçohet apo errësohet me ngjyrë të bardhë apo të zezë. Tone akromatike janë të gjitha tonet që fitohen me përzierje të përbashkët të ngjyrës së zezë dhe të bardhë.

Nëse bëjmë më tepër tone të cilat ngadalë ndryshojnë nga më e ndritshme apo errët, fitojmë shkallëzime tonal. Me shkallëzime tonal mundemi të fitojmë shkallë tonale kromatike dhe akromatike.

Me përdorimin e tyre artistët i modelojnë format dydimensionale në pikturë me të cilën fitojnë iluzion të vëllimit.

Nëse në veprën figurative kombinojmë tone më të ndritshëm dhe më të errët fitojmë dinamike në pikturë.



Ton në realitet, hapësirë, fotografi




Tone kromatike



Tone akromatike



Huskoviq: **Peizazh**, akrilik



Pablo Pikaso: **Jeta**, vaj në pëlhurë



Rembrandt: **Apostol**, vaj në pëlhurë (tone harmonike)



Dragan Najdenovski: **Zonë**, vaj në pëlhurë

HAPËSIRA

Hapësira është element figurativ.

Hapësirë reale është ajo e cila na rrethon, në të cilën jetojmë, në të cilën lëvizim, në të cilën mësojmë, flemë, në të cilën fluturojnë zogjtë dhe aeroplanët, rrjedhin lumenjtë, rriten pyjet dhe lulet. Në pikturat e artistëve shohim hapësirë, por ajo nuk është e vërtetë, atë e quajmë iluzion i hapësirës.

Artistët fitojnë iluzion të hapësirës në mënyra të ndryshme, me tone, me ngjyra të ndritshme dhe të errëta, me forma të mëdha dhe të vogla, me gërshetim të formave njëra pas tjetrës dhe me ngjyra të ngrohta dhe të ftohta.



Kamij Pissaro: **Bulevari Mon Marte në mbrëmje**, vaj në pëlhurë
(iluzion i hapësirës)

Në rrethinën tonë, në natyrë, në mal, në qiell, pyje, ujëra, mundemi të shohim pasuri të toneve të një ngjyre. Artistët në veprat e veta përdorin tone të ndryshëm më të errëta dhe më të ndritshme që ta paraqesin iluzionin e hapësirës dhe vëllimit.

Iluzioni i hapësirës fitohet edhe me madhësi. Format më të vogla duken më larg nga ato që janë të pikturuara më të mëdha. Nëse një objekt e vendosim pas tjetrit, ai objekt do të duket më larg se i pari.

Paraqitja e hapësirës në veprat figurative arrihet edhe me përdorimin e perspektivës.

Artistët me përdorimin e perspektivës kanë arritur rezultatet më të mira në paraqitjen e hapësirës së jashtme dhe të brendshme.



Z. Miliq: **Luginë**, vaj në pëlhurë



Vizatim i fëmijëve, hapësirë me perspektivë dhe ton



Perspektivë

BARASPESHA

Përdorimi i baraspeshës në pikturim është qëllim i secilit artist figurativ.

Baraspeshë në mënyrë më të thjeshtë fitohet me aplikimin e simetrisë kur ana e djathtë dhe e majtë e veprës janë identike.

Baraspeshë asimetrike është kur arrihet baraspeshë por me dallime në dy gjysmat. Për shembull: kur përdorim hapësirë me ton më të ndritshëm në njërin anë, e në anën tjetër arrijmë baraspeshë me ton më të errët. Çfarë do të jenë madhësitë e tonit të errët apo të ndritshëm artisti i cakton sipas ndjenjës së tij për baraspeshë.

Secili artist zhvillon shikim të vet të baraspeshës që rrjedh nga karakteri i tij, ndjenja dhe eksperiencia në krijimtari.



Jan Arp: **Mali njëqind çengele**, vaj në karton




Rada Popova Malkiq: **Pa titull**, tapiceri (simetri)



Dimitar Kondovski: **Pa titull**, vaj në bazë druri



Edvard Munk: **Valsi i jetës**, vaj në pëlhurë (asimetri)



Vladimir Georgievski: **Zbërthim i ndritshëm**, vaj në pëlhurë



Pablo Pikaso: **Mandolina dhe kitara**, vaj në pëlhurë (asimetri)

AKUAREL

Të përkujtohem se akuari është teknikë e pikturimit në të cilën ngjyrat dallohen me ujë. Pikturohet në anën e vrazhdë të letrës dhe me këtë teknikë mund të fitohen tone të buta të ngjyrës, të lehta dhe të tejdukshme dhe nuk mund të pikturohet mbi ngjyrë.



Albrecht Direr: **Rrugë në Vinzburg**, akuael



Vladimir Georgievski: **Krishti në sofër**, akuael

Veprat akuael duken të freskëta dhe lehtë dhe shumë shpesh autorët me këtë teknikë pikturojnë natyrë, male, peizazhe, fusha, lumenj, lule dhe sipërfaqe të gjëra të ujit. Hapësira me teknikën e akuaelit fitohet me vendosjen e toneve të ndritshme dhe të errëta, e po ashtu edhe me ngjyra të ftohta dhe të ngrohta për larg dhe afër.



Vepër e fëmijëve, akuael, (nxënës 9 vjeçar)



Vepër e studentëve, akuael

TEMPERA

Edhe me këtë teknikë takohemi në shkollë. E dimë se tempera është teknika më e vjetër me të cilën janë pikturuar freskat nëpër kisha dhe manastire. Në kohën e vjetër artistët vetë e kanë përgatitur ngjyrën.

Me temperë pikturohet në anën e vrazhdë të letrës, mundet të fitohen ngjyra të forta dhe intensive, të fitohen tone të ndryshëm me përzierjen e të bardhës dhe të zezës ose të gjenden shumë ngjyra tjera me përzierje të përbashkët sipas dëshirës.

Me përdorimin e ngjyrave të forta dhe intensive në vepër fitohen kompozime të pasura koloristike.

Me temperë kemi mundësi të pikturojmë motive dhe objekte nga natyra me paraqitjen e iluzionit të hapësirës.



Miniaturë nga Evangjelia Dobreshinit, temperë



Anxheliko: **Shën Katerina**, detal i kompozimit, temperë

GVASH

Gvashi poashtu është teknikë në të cilën ngjyra hollohet me ujë. Pikturohet me ngjyra akuarel dhe temperë të bardhë në tubë. Me këtë kombinim mundemi të fitojmë tone të lehta dhe senzitive sikur se akuareli, e kur e përziejmë ngjyrën me temperën e bardhë mundemi të pikturojmë mbi ngjyrë.

Gvashi është kombinim me ndihmën e të cilit mundemi të shprehemi me mundësitë e akuarelit dhe temperës.

Pikturohet në anën e vrazhdë të letrës me brusha të cilat kanë fije të buta me maje. E gjithë ajo që mund të arrijmë me akuarelin dhe temperën mundemi ta arrijmë me teknikën gvash.



Vepër me gvash




Vepër me temperë



Vepër me gvash



Vepër me gvash



Eleni Xhanioti: **Qytete**, temperë



Vepër me gvash



U njoftuam se grafika është fushë e posaçme figurative në të cilën vepra figurative fitohet vetëm me shtyp.

Sipas asaj në cilën teknikë e shtypim grafikën, mundemi ta ndajmë në shtyp të thellë, të lartë, rë rrafshët, të depërtueshëm dhe të kombinuar. Në kohët më të reja, me paraqitjen e kompjuterit kemi grafikë kompjuterike.

Që të mundemi të shtypim grafikë, së pari duhet



Makinë e vjetër për shtyp



Efekte të ndryshme grafike të shënimit në bakër

të kemi bazë, siç është linoleumi, kartoni, druri, guri, apo pllaka metali. Pllaka në të cilën e realizojmë idenë dhe me të cilën e shtypim grafikën quhet matricë. Matrica përpunohet me vegla të posaçme me të cilat e gdhendim apo e thellojmë, apo e përpunojmë me mjete kimike të veçanta. Kur klisheja është e gatshme për shtyp. Duhet të merret një cilindër me të cilin e vendosim ngjyrën grafike, letër speciale në të cilën shtypet dhe makinë e cila me shtypje e realizon grafikën si vepër artistike.

Nëpër shkolla nxënësit krijojnë grafika me mjete më të thjeshta, me ngjyra temperë

në vend se me ngjyra grafike dhe pa makinë shtypëse por me shtypje të thjeshtë me dorë apo ndonjë mjet cilindrik.

Shtypi i lartë është kur matrica thellohet, por ngjyra me cilindër vendoset në pjesët e larta, e pjesët e thelluara mbesin të bardha. Llojet e teknikës me shtyp të lartë janë: karton-shtyp, drugdhendje dhe gravurë e linoleumit.

Shtyp i thellë është kur matrica gdhendet dhe vizatohet, e ngjyra shtypet në pjesët e gdhendura, e prej atje transferohet në letërën e shtypit.

Teknika të shtypit të thellë janë: gdhendja e bakrit, shënimi në bakër, gjilpëra e thatë, akvatina dhe linografia.



F. M. Janzen: **Drurë të zhveshur**, shënim në bakër



Matricë për shtyp nga linoleum



Gjurmë nga matrica

Shtyp i rrafshët është kur matrica për shtyp punohet me mjete kimike e jo fizikisht me gdhendje dhe thellësim. Teknika të shtypit të rrafshët janë: monotipia dhe litografia.

Shtyp lëshues është kur për matricë përdoret pëlhurë speciale e mëndafshit e cila e lëshon ngjyrën gjatë shtypit.

Matrica e rretit përpunohet në mënyrë kimike. Teknikë e njohur është sito shtyp.

Shtyp i kombinuar është kur një grafikë realizohet me kombinim të dy apo më tepër teknikave.

Sot në botë grafika kompjuterike zë vend mes teknikave tjera klasike.

Kompjuteri ka mundësi të pakufizuara për realizim të një grafike bashkëkohore dhe i kënaq autorët si mjet për krijimtari artistike. Me përdorimin e programeve kompjuterike për shprehje të krijimtarisë autori mund të kombinojë dhe të përdor elementet dhe principet figurative në një tërësi, të përdor vija të ndryshme, forma të ndryshme, ngjyrë, ton, teksturë dhe gjithë atë që grafikën e bën vepër artistike.

Gjatë përpunimit të kësaj grafike, autori para vetes në monitor e sheh pamjen përfundimtare të grafikës dhe mund ta shtyp kur të jetë i kënaqur nga vepra e vet.


Shtypja në këtë medium është shumë e thjeshtë, bëhet me printim dhe nuk ka nevojë për përpunim të matricave në mënyrë klasike, vegla për gdhendje dhe gravurë, ngjyrë shtypi dhe cilindër, si dhe makinë grafike, respektivisht presë për shtyp.



Riçard Ejber: **Pa titull**, monotipi



Daniel Ozmo: **Autoportret**, linogdhendje



Burhan Ameti: **Spirit way**, grafikë digjitale



Huskoviq: **Takim në birucë burgu**



Tulus Lotrek: pllakat, 1893

VIJA

Grafika sikur se të gjitha veprat figurative i përdor të gjitha elementet dhe principet figurative të gjuhës figurative, por si zonë specifike vija, ngjyra, toni, tekstura dhe forma janë mjetet kryesore për shprehje grafike.

Vija në të gjitha llojet e shtypit, edhe në grafikën kompjuterike, mbetet element themelor për shprehje. Varësisht nga lloji i teknikës, bukuria dhe pasuria e vijës edhe vizatimi janë bazë të shprehjes grafike.



Ilija Kočovski: **Bukuroshja dhe bisha**, drugdhendje



Ordan Petleski: **Konstruksione të vjetra**, drugdhendje


Artisti grafik i kombinon vijat e drejta, të lakuara, të trasha dhe të holla, të gjata dhe të shkurtra në kombinime të ndryshme. Me vijën fiton shrafurë e cila ka qenë më së tepërmi e përdorur nga mjeshtërit e vjetër grafik. Me vizatim fitohet iluzion i hapësirës dhe thellësi, si dhe ndarje të sipërfaqeve të caktuara me teksturë.



V. Radovani: **Valë**, litografi

TEKSTURA


Tekstura është një nga mjetet kryesore të shprehjes gjatë përpunimit të grafikës. Me thellësim, gdhendje, e më së tepërmi me procedurë kimike në shënim në bakër, akvantina, gjilpëra e thatë dhe litografi, artisti fiton tekstura të ndryshme të cilat janë karakteristike për grafikën.



Vepër e fëmijëve, linogdhendje



Drugdhendje, autor i panjohur



Burhan Ahmeti: **Rugë e ngjyrosur**, grafikë digjitale

TONI

Toni është mes vlerave të para të grafikës në teknika të caktuara. Pasuria më karakteristike dhe më e madhe, si dhe llojlojshmëri të toneve fitohet me shtypin e thellë, më së shumti në teknikën akvantina në shënim në bakër ku me procese fizike dhe kimike grafiku mund të fitojë numër të pafund të toneve.



Rembrant: **Tre kryqe**, shënim në bakër



Endru Gedes: **Portret i nënës**, shënim në bakër



Portret vajzë, litografi



Rembrant: **Vdekja e Marisë**, shënim në bakër




Dimçe Nikollov: **Zonë XXI**, vizatim me bakër

NGJYRA

Ngjyra është shumë prezent në grafikë. Në teknikat klasike numri i ngjyrës varet nga numri i matricave.

Nëse duam të shtypim grafikë me dy apo më tepër ngjyra duhet të përgatisim më tepër matrica, për secilën ngjyrë bëhet matricë e posaçme dhe secila ngjyrë shtypet vetë, njëra pas tjetrës.



Danço Ordev: **Alfa 90/2**, Serigrافی me ngjyrë




S. Shemov: **Fëmija tregon me gisht nga yjet**, serigrافی

FORMA

Sikur se në të gjitha veprat figurative, forma është element i rëndësishëm për vlerën e grafikës. Pa dallim se a bëjmë grafikë reale me ndonjë motiv apo kompozim abstrakt, forma luan rol të rëndësishëm e cila i bashkon vijën, tonin, teksturën dhe ngjyrën në një tërësi.



Pablo Pikaso: **Buf i madh**, litografi




Hans Balding Grien: **Kalorës i magjepsur**, gdhendje në bakër

MONOTIPIA

E dimë se monotipia është teknikë e cila dallohet nga teknikat tjera grafike sipas asaj që me të mund të shtypim vetëm një kopje.

Në pllakë qelqi, metali apo plastike vendoset ngjyra, një apo më tepër, në pllakën me ngjyrë vendoset fletë letre dhe me dorë apo me ndonjë mjet tjetër shtypet letra.

Me këtë teknikë mundemi të eksperimentojmë me një apo më tepër ngjyra, të vizatojmë, të gravojmë, të shtypim tekstura të ndryshme natyrale apo artificial dhe çdo herë të fitojmë shtyp interesant.



Sen Frensis: **Pa titull**, monotipi




Edgar Dega: **Peizazh**, monotipi



Proces i shtypit me monotipi



Vepër e fëmijëve, monotipi



Xhejk Bertot: **Pa titull**, monotipi

SHËNIM NË BAKËR

Shënimi në bakër është teknikë grafike e shtypit të thellë. Shtypi fitohet nga pllakë bakri (zinku) kur mbi atë vendoset vizatimi i dëshiruar.

Shënimi në bakër realizohet në këtë mënyrë:

- Mbi pllakë metali vendoset llak asfalti dhe presim të thahet. Pastaj me gjilpërë të mprehtë vizatohet ideja dhe gravohet llaku nga vendi ku duhet të ketë vijë.

- Pastaj vendoset pllaka në enë me acid (acid sulfuri apo oksid hekuri)

- Acidi e bren pllakën në vendet ku është i larguar llaku, respektivisht në vendin e vizatimit.

- Sipërfaqja e pllakës fshihet lehtë nga teprica e ngjyrës dhe kemi kujdes që ngjyra të mbetet në vijat.

- Shtypet me presë për shtyp të thellë: mbi pllakë me ngjyrë vendoset letër e lagur e cila hyn në thellësitë e pllakës dhe e tërheq ngjyrën në vete, respektivisht në letër.

Shënimi në bakër mundëson realizim të vijave të holla, të ndjeshme, suplite, por edhe të forta dhe precize.

Sipërfaqe me këtë teknikë fitohen me ndihmën e teksturës/gravurës nga vija në kahje të ndryshme. Mundëson edhe realizim me më shumë ngjyra,

por për secilën ngjyrë duhet nga një matricë e posaçme. Të gjitha matricat një nga një shtypen në fletë letre të njëjtë.



F.M. Janzen: **Pemët e zhveshura**




Pablo Pikaso: **Në kafene,** shënim në bakër



Petar Haxhi Boshkov: **Grafika X,** litografi



Edvard Dega: **Autoportret,** shënim në bakër



Dimçe Nikolov: **Rajon,** shënim në bakër



Pol Kle: **Dy burra,** shënim në bakër

Veprat figurative të skulpturës janë karakteristike nga ajo që kanë formë tredimensionale, respektivisht zënë një pjesë të hapësirës me vëllimin e vet. Skulptura mund të jetë e realizuar si skulpturë stabile dhe mobile. Në skulpturën stabile dallojmë plastikë të plotë dhe relief, e në atë mobile veprën e emërojmë si mobil.



Ogist Roden: **Balzak**, gips



Skulpturë lindore

Plastika e plotë është vepra figurative më prezent në skulpturë. Ajo është vepër e pavarur tredimensionale e cila qëndron në hapësirë të caktuar të brendshme apo të jashtme, në të mbyllur apo të hapur.

Plastikën e plotë mundemi ta shikojmë dhe të kënaqemi me të nga të gjitha anët që njëkohësisht na mundëson ndjenjë të ndryshme të formave dhe vëllimit.




Vepër nga letra



Portret i Gudea, gurë

Për dallim nga plastika e plotë e cila është statike, plastika mobile është vepër e cila është në lëvizje. Mobili është skulpturë e cila është në lëvizje kështu që shikuesi është dëshmitar i ndryshimit të skulpturës.

Lëvizja e skulpturës varet nga ideja e artistit, a do të lëviz me mekanizëm apo në mënyrë natyrale.



Aleksadnar Kalder: **Mobil në qetësi dhe lëvizje**



Mobil në hapësirë



Aleksandar Kalder: **Fleta të kuqe**, mobil

SKULPTURA

FUSHA FIGURATIVE

80

57

Artistët, veprat e veta i ndërtojnë me kombinim të llojllojshmërisë të vëllimit në një tërësi. Nëse skulptura është me vëllim i cili duket i mbushur, fort, plot dhe sikur të jetë bërë nga një pjesë, themi se është masë monolite. Nëse skulptura është e formuar nga vëllimi i cili ka kombinim të vijave dhe forma të zgjatura që hyjnë në hapësirën e skulpturës themi se ajo është zgjedhje lineare e skulpturës.

Skulptura punohet nga materiale të ndryshme siç janë: guri, druri, terakota, qeramika, metali, gipsi, bronzi por edhe nga materiale tjera siç janë: plastika, qelqi, letra dhe hedhurinat.

Varësisht nga materiali nga i cili është punuar skulptura, ajo realizohet në më tepër mënyra.

Gjatë punës me argjilë skulptori punon me modelim, respektivisht me shtim dhe heqje. Kur punon me gurë dhe dru punohet vetëm me heqje, e kur punohet me metal vepra punohet me gdhendje, konstruktim, aplikim etj.

Në skulpturë vepra modelohet, konstruktohet, aplikohen forma ose radhiten më tepër forma në një tërësi. Gjatë realizimit të skulpturës përdoren vegla të ndryshme prej daltave speciale për materiale të ndryshme (dru, gurë) deri te veglat bashkëkohore për ngjitje dhe makina për përpunim të materialeve.



Vencislav Rihter: **X-1**, aluminium



Tome Serafimovski: **Kiril Pejçinoviç**, bronzë



Pablo Pikaso: **Gitara**, letër



Pikaso: **Mace**, teknikë e kombinuar



Vepër prej letre




Skulpturë mobile

FORMA - VËLLIMI

Forma, respektivisht vëllimi është element themelor figurativ i cili e krijon skulpturën. Vepra krijohet me kombinim të pasur të vëllimit i cili mund të jetë i thjeshtë dhe i ndërlëkuar, këndor dhe i rumbullakët, i hapur dhe i mbyllur, i mbushur dhe i zbrazët, i theksuar dhe i thelluar, i plotë dhe i perforuar.

Kur vëllimi merr hapësirë të caktuar dhe nuk është i mbushur me material, ai ka vetëm vëllim, por nëse forma është e mbushur plotësisht me material atëherë themi se ka masë. Për shembull: topi ka vëllim të caktuar por nuk është i mbushur me ajër, derisa guri merr vëllim dhe masë të njëjtë.



Portret i romakut, Romë, mermer

Dushan Xhamonja: **Skulpturë metalike 83**, metal



Vasil Vasilev: **Portret asociativ I**, dru



Ogist Roden: **Puthje**, gurë



MADHËSIA

Në të shumtën e rasteve skulptura është me madhësi reale, por mund të jetë edhe shumë e vogël dhe shumë e madhe. Veprat e vogla i quajmë miniaturë, e të mëdhatë skulptura monumentale. Posaçërisht skulptura që është me madhësi jashtë natyrale dhe paraqet ndonjë ndodhi të rëndësishme historike apo ndonjë person, e quajmë monument.



Shtatorja e mbretit Gudea, Mesopotami, gurë

BARASPESHA

Sikur se në veprat tjera figurative edhe në skulpturë qëllimi është të arrihet baraspesha. Baraspesha edhe këtu arrihet me ndihmën e simetrisë dhe asimetrisë. Baraspesha simetrike aplikohet shumë pak derisa baraspesha asimetrike është më shumë prezent për shkak se ka vlerë më të madhe figurative.



Familje, skulpturë (asimetri)



Imperatori Avgust, Romë, bronzë



Tome Serafimovski: **Shën Kiril dhe Metodi**, bronz



Dimçe Todorovski: **Vrimë**, bronzë




Ogist Roden: **Tre piktura**, bronzë (asimetri)

RITMI

Në secilën skulpturë mundemi të shohim lëvizje të caktuar, respektivisht dinamikë të vëllimit.

Artisti në skulpturë kryesisht vendos ritëm të lirë i cili rrjedh nga kreativiteti dhe ideja e tij.



Vencislav Rihter: **Reliefometër II**, metal (ritëm i lirë)



Dushan Xhamoëa: **Skulptura**, metal (ritëm i lirë me formë)


VIJA

Vija si element figurativ në skulpturë kombinohet me sipërfaqen e vëllimit apo me vetë idenë e skulpturës. Nëse vepra është e ndërtuar me forma të holluara, të cilat asocojnë në vija, themi se kemi skulpturë më formë të vijave të holluara.

Vija përdoret për fitim të teksturës në sipërfaqe me të cilën pasurohet vlera figurative e veprës.



Vepër e fëmijëve, tel



Jan Tingveli: **Metamekanika**, tel



A. Kalder: **Trungu familjar**, tel



Gruner: **Karrige**, tel



Petar Haxhi Boshkov: **Vertikale**, bronzë

NGJYRA

Ngjyra është shumë shpesh prezent dhe kombinohet me vëllimin në skulpturë. Ngjyra takohet edhe në skulpturat e civilizimeve të vjetra dhe sot në skulpturën moderne.

Në skulpturën modern ngjyra pothuajse ka rëndësi të njëjtë me formën.



Sarkofag egjiptian, dru



Artist nga Hopeh: **Statua e Arhotit**, qeramikë e ngjyrosur

PROPORCIONI

Proporcioni si princip në të cilin mes veti kombinohen madhësi të ndryshme në një tërësi është prezent që nga civilizimet e hershme e deri më sot. Qëllimi i çdo skulpture është që të gjendet raport ideal i formave me të cilat do të vjen deri tek bukuria ideale. Kjo posaçërisht është prezent tek autorët të cilët e paraqesin trupin e njeriut.



Hermes, Praksitel, Greqi



Portret, argjilë

HAPËSIRA

Skulptura merr hapësirë, vendoset dhe qëndron në hapësirë, e zbukuron dhe është pjesë e asaj hapësire. Forma dhe hapësira janë në interaksion respektivisht veprojnë njëra ndaj tjetrës. Shpesh herë skulptura bëhet për hapësirë të caktuar dhe artikullohet me hapësirën si një tërësi.



Stanko Pavleski: **Vijë drejt diellit**, inoks



Skulpturë në hapësirë

DIZAJN DHE KOMUNIKIME VIZUALE

FUSHA FIGURATIVE

62

Dizajni merret me formësimin e jashtëm të gjithë asaj që e përdorim dhe e blejmë për nevojat tona të përditshme dhe atë që e shohim me qëllim që të na informojë apo të na udhëzojë për diçka.

Në këtë fushë figurative punojnë artistë figurativ të cilët i quajmë dizajnerë. Në komunikimet vizuale i emërojmë si dizajner grafik, e tjerët janë dizajnerë për tekstil, mobilie, ambalazh, qelq, qeramikë, e ata që dizajnojnë veshmbathje i quajmë kreatorë të modës, e artistët të cilët dizajnojnë kostume për teatër dhe film i quajmë kostumografë.



Veshmbathje për fëmijë



Pllakat



Pllakat



Karrocë për fëmijë



Dizajn i karriges



Veshmbathje për fëmijë



Vegla për ushqim

DIZAJN DHE KOMUNIKIME VIZUALE

FUSHA FIGURATIVE

60

63

Industria prodhon miliona produkte të ndryshme në çdo minutë për nevojat e njeriut. Secili prodhim e tërheq blerësin me pamjen e tij estetike, si për shembull: automjeti, lodrat, stolitë, aparatet e amvisërisë, etj. Këtë lloj të formësimit estetik e quajmë dizajn industrial.



Komplet enë për ushqim



Parfum



Vokmen



Automjet



Këpucë për futboll



Automjet



Motoçikletë



Karrige

DIZAJN DHE KOMUNIKIME VIZUALE

FUSHA FIGURATIVE

64

Në komunikimet vizuale siç janë: pllakati, librat, gazetën, revistat, bilbordet, pamfletet, reklamat dhe e gjithë ajo që shtypet e punojnë dizajnerët grafik.



Simbol i mbrojtur

MODA 8




Kopertinë e revistës



Plakat



Mbështjellëse për CD muzikore



Plakat filmik

DIZAJN DHE KOMUNIKIME VIZUALE

FUSHA FIGURATIVE

60

65

Kostumografia, respektivisht dizajni i tekstilit dhe krijimtaria e modës janë lëmë të cilat kanë domethënie të madhe për jetën e njeriut bashkëkohor. Këto tre lëmi i bashkojnë funksionet e veta me qëllim që ta veshin njeriun në mënyrë moderne.



Kostum historik



Kostum historik



Kostum historik



Kostum

Posaçërisht kostumografia është në funksion të dizajnojë veshmbathje për shfaqje teatrale apo film me të cilën do t'i prezantojë kohën në të cilën ndodh ngjarja. Kostumografët duhet të kenë njohuri nga historia dhe çfarë veshmbathje kanë mbajtur njerëzit në periudhë të caktuar historike, e njëkohësisht çfarë kanë qenë veshmbathjet e njerëzve nga profesione të ndryshme, të njerëzve të rëndomtë, të pasur, udhëheqësit, klerikët, ushtria, etj.

Ekziston edhe shkencë e posaçme e cila e studion historinë e kostumit dhe e cila shfrytëzon informata nga dokumente të shkruara dhe nga veprat e vjetra të artistëve figurativë të vjetër dhe nga fotografitë dhe freskat e murit që janë të njohura në art.



Kostum filmik



Kostum filmik



Kostum teator



Kostum filmik




Jordan Grabulovski Grabul: **Simbole vendore**, çimento e bardhë



Tome Serafimovski: **Kiril Pejčinoviç**, bronzë



Rodoljub Anastasov: **Njeri dhe hapësirë CXI**, vaj në pëlthurë



Stefan Manefski: **Ritëm i lirë**, matal



Tanas Lulovski Tane: **Autoportret**, akrilik në pëlthurë



Vllado Georgievski: **Qingj i shenjtë**, vaj në pëlthurë



Adem Kastrati: **Korje**, vaj në pëlthurë



Vasko Tashkovski: **Plazhi i dinozaurusëve**, vaj në pëlhurë



Danço Ordev: **Peizazh**, vaj në pëlhurë



Dushan Perçinkov: **Pyll dhe re**, vaj në pëlhurë



Simon Shemov: **nga cikli Gruaja**, punim me dorë nga letra



Gligor Çemerski: **Gretxa e çmendur**, vaj në pëlhurë



Ana Temkova: **Shën Joakim Osogovski**, vaj në pëlhurë

Kostadin Tançev-Dinka: **nga cikli që paraqet gjyshja Gina**, sito shtyp me ngjyrë



A

Amator – dashamir i artit i cili ka profesion tjetër personal, por merret me krijimtari figurative nga dashuria e jo profesionalisht.

Animalist – artist figurativ i cili merret me paraqitjen, respektivisht vizatimin dhe skulpturimin e kafshëve.

Antika – emërtim i të gjitha kulturave të vjetra, posaçërisht asaj romake dhe greke.

Art abstrakt – drejtim në artin modern i cili mënjanon paraqitjen e botës reale dhe krijon me forma të lira.

Arabeska - ornament në stil arab i cili është i përbërë nga elemente të stilizuara gjeometrike.

Atelie – punëtori, hapësirë e artistit figurativ apo e njerëzve me profesione kreative.

Ambalazh – dizajnim figurativ i materialit me të cilin pakëtohet dhe shitet prodhimi.

Arti figurativ – emërues i përbashkët për arkitekturën, pikturimin, skulpturimin dhe grafikën, vepra të cilat njeriu në mënyrë kreative i krijon.

Arti i zbatueshëm – emërtim i sendeve të formësuara figurativisht për përdorim.

B

Barelief – relief i ulët dhe i cekët në skulpturë.

Bienale – ekspozitë e cila mbahet çdo dy vite.

Bust – paraqitje e kokës dhe pjesës së epërme të trupit të njeriut në skulpturë.

D

Dekorim – stolisje e hapësirës, si dhe forma të veçanta për stolisje.

Dizajn – vizatim dedikuar për formësim të prodhimeve për prodhimtari industriale.

Dizajner – artist, specialist për formësim estetik të objekteve ose sipërfaqeve për prodhimtari industriale.

Dizajn industrial – formësim figurativ për përdorim të përditshëm të cilat prodhohen në industri.

F

Faktura – sipërfaqe e veprës artistike në pikturim me të cilën fitohen disa veçori të sipërfaqes.

Figurativitet – karakteristikë e veprës artistike kur në të mund të shihet fytyrë konkrete, përmbajtje apo motiv.

Fletë grafike – vepër figurative grafike e shtypur.

G

Galeri – hapësirë e ndërtuar për ekspozim të veprave figurative.

Gvash – teknikë vizatimi me ngjyra uji dhe temperë të bardhë.

Grafikë reproduktive – kopje apo vepra të cilat nuk janë të shtypura me dorë, por me shtyp ofset industrial.

H

Histori e artit – shkencë për zhvillimin e drejtimeve artistike, vlerën e tyre dhe domethënien historike.

I

Ilustrim – pikturë apo vizatim lidhur me ngjarje nga teksti i shkruar.

Iluzion – iluzion në pikturë është paraqitja e hapësirës, tonit, perspektivës etj.

K

Katalog – publikim në të cilin janë të shënuara të gjitha veprat e muzeut, galerisë, ekspozitës apo krijimtaria e artistit.

Kiç – produksion joartistik. Kiç është vepër e cila krijohet nga dëshira e lirë për pëlqim, do të thotë paraqitet si rezultat i rrethinës të pazhvilluar artistike.

Kolorit – ngjyrshmëri, veçori, shprehje, efekt i veprës figurative i arritur me ngjyrë.

Kopje – vizatim i shpejtë dhe i lehtë me vija të thjeshta dhe me pak detaje.

FJALOR I SHPREHJEVE



L

Lineare – karakteristikë e veprës pikturale, grafike apo skulpturale, në të cilën mjet kryesor i shprehjes është vija.

M

Marina – paraqitje figurative i peizazheve detare.

Miniatura – pikturë apo skulpturë në format të vogël.

Mozaik – vepër figurative e cila punohet me bashkimin e katrorëve të vegjël me ngjyra të ndryshme nga qelqi, guri, etj.

Monografia – libër në të cilin janë paraqitur jeta dhe vepra e ndonjë artisti.

Monokronia – vepër figurative e punuar vetëm më një ngjyrë.

Mbështjellës – formësim figurativ, dizajnim i kopertinës së librit apo material tjetër reklamues.

N

Natyralizëm – tentim i artit, objektet të paraqitën në mënyrë më të vërtetë dhe më reale.

Ngjyrë lazure – vendosje e ngjyrës së tejdukshme nëpërmjet të cilës mund të shihet baza.

O

Ornament – forma gjeometrike apo zoomorfe të stilizuara me të cilat është

zbukuruar ndonjë hapësirë të cilat mund të përsëritën apo variojnë.

P

Paleta – sipërfaqe në të cilën piktori i përziën ngjyrat para se t'i vendos në vepër.

Panorama – paraqitje e natyrës me pamje të gjera dhe të largëta.

Peizazh – pikturë në të cilën është paraqitur natyra.

Profil – pamja e fytyrës apo sendeve të shikuara prej anash.

S

Signatura – nënshkrim personal i artistit në pikturë, grafike apo skulpturë të cilën e ka punuar.

Skica – fotografi, skulpturë e shpejtë dhe e parregulluar.

Stilizim – thjeshtësim, transformim i formave prej asaj natyrale në forma të thjeshta.

Skulpturë galerike – skulpturë e cila sipas madhësisë mundet të ekspozohet në galeri (madhësi reale dhe miniaturë).

Sh

Shtafelaj – mbajtës pikture në të cilën artisti vendos pikturën gjatë punës.

Shtyp i rrafshët – teknikë grafike pa thellësim të bazës (sito shtyp, monotipi).

T

Tapiceri – emërtim i përgjithshëm për vepra figurative të punuara nga tekstili.

Terakota – emërtim i përgjithshëm për prodhime argjili të cilat janë forcuar me pjekje.

Triptik – vepër figurative e përbërë prej tre pjesëve.

V

Valer – fjalë frënge për ton.

Vinjeta – vizatim i vogël që shërben për zbukurim të ndonjë teksti.

Vitrazh – dritare apo hapësirë qelqi e punuar apo stolisur me pjesëza qelqi me ngjyra të ndryshme.

Vizatim – vepër figurative në sipërfaqe, e krijuar me vijë si mjet kryesor i shprehjes.

Zh

Zhanër – paraqitje e pikturave të jetës së përditshme nëpërmjet veprave figurative.

TEST 1

70

EMRI DHE MBIEMRI _____

1. Numëro cilat janë ngjyrat primare:

1. _____
2. _____
3. _____

2. Numëro cilat janë ngjyrat sekondare:

1. _____
2. _____
3. _____

3. Numëro elementet figurative të gjuhës figurative:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____

4. Numëro principet figurative të gjuhës figurative:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____

5. Numëro tre teknika të pikturimit:

1. _____
2. _____
3. _____

6. Numëro tre teknika të grafikës:

1. _____
2. _____
3. _____

7. Në cilën fushë figurative bën pjesë reliefi? _____

8. Vizato teksturë të lëmuar dhe të vrazhdë në katrorët!

--	--

TEST 1

71

9. Krijò vepër kolazh me ngjyra të ftohta!

10. Krijò vepër kolazh me ngjyra të ngrohta!

11. Vizato shkallë tonale kromatike!

12. Vizato shkallë tonale akromatike!

13. Paraqit hapësirë me gërshetim!

14. Vizato objekte me vijë konturale!

15. Vizato vepër me simetri!

16. Numëro tre artist figurativë maqedonas!

TEST 2

72

EMRI DHE MBIEMRI _____

1. Zgjedh cila nga këto dy piktura të pëlqen më tepër?




K. Ivanoviq: **Rrush**, vaj në pëlhurë




Pablo Pikaso: **Ibrik dhe enë për pemë**, vaj në pëlhurë

2. Transformo këtë pikturë tonale në koloristike!



3. Krijo ritëm alternativ!



4. Paraqit gradacion me madhësi!



5. Plotëso ngjyrat komplementare!



TEST 2

6. Paraqit ritëm me vija kontraste!

7. Paraqit ritëm me formë!

8. Vizato natyrë të vdekur!

9. Numëro tre teknika grafike!

1. _____
2. _____
3. _____

10. Numëro një autor dhe një vepër të tij të njohur!

autor _____
vepra _____


11. Numëro tre materiale në skulpturë!

1. _____
2. _____
3. _____

12. Numëro tre teknika në pikturim!

1. _____
2. _____
3. _____

13. Me ton paraqit iluzion të vëllimit të objekteve!



14. Numëro tre artist figurativ botërorë:

1. _____
2. _____
3. _____

